



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 qershor 2011
Nr. ref.: RK123/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 115/10

Parashtruesi

Gjokë Dedaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të
Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Mirëbesimit, SCC-04-0104, të datë 23 tetor 2007**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Gjokë Dedaj, me vendbanim në Pejë dhe i përfaqësuar nga z. Zef Prenaj, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), SCC-04-0104, të 23 tetorit 2007, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 korrik 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Dhomës së Posaçme, me pretendim se është bërë “shkelje serioze e procedurave kontestimore duke mos ftuar palët në procedurë, duke marrë një aktvendim të mangët [...]” dhe “duke mos dhënë të drejtën për ankesë”.
4. Parashtruesi i kërkesës, duke supozuar se kërkesa është jashtë afatit kohor të paraparë në nenet 49 dhe 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkon që kërkesa të kthehet në situatën e mëparshme sipas nenit 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 18 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 nëntor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 115/10, emëroi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 115/10, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.
8. Më 21 janar 2011, kërkesa iu përcoll Dhomës së Posaçme.
9. Më 28 janar 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të autorizojë avokatin e tij, çfarë edhe bëri më 3 shkurt 2011.
10. Më 23 maj 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 gusht 1993, në një ankand të hapur nga Ndërmarrja shoqërore “Stacioni për mbrojtjen e bimëve” (në tekstin e mëtejme: NSH) në Pejë, parashtruesi i kërkesës bleu një lokal afarist në rrugën “Rexhep Ali Bajrami” p.n, për një shumë prej 40.500 markash gjermane (në tekstin e mëtejme: MGJ).
12. Më 6 korrik 1994, Departamenti për çështje Ligjore e Pronësore i Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë mori Vendimin (011 no: 464-08-03056/94) për kërkesën e NSH që të marrë lejen e Departamentit për të bartur lokalin afarist tek blerësi (parashtruesi i kërkesës), në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi kushtet e veçanta të bartjes së pronës së patundshme (Gazeta Zyrtare e RS të Serbisë, Nr.30/89 dhe 42/89) dhe nenit 202 të

Ligjit mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative. Kërkesa ishte refuzuar, ngase po të lejohej do të ndikonte në strukturën kombëtare të popullsisë ose risistemimin e pjesëtarëve të një kombi apo etnie të caktuar, dhe një bartje e tillë do të shkaktoje shqetësim, apo pasiguri a pabarazi mes pjesëtarëve të kombeve apo kombësive të ndryshme sipas nenit 3 të Ligjit mbi kushtet e veçanta të bartjes së pronës së patundshme.

13. Më 29 korrik 2001, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) që t'ia njoh të drejtën e pronësisë ndaj lokalit afarist.
14. Më 13 gusht 2003, parashtruesi i kërkesës filloi procedurat në Gjykatën Komunale të Pejës për certifikimin e lokalit afarist.
15. Më 31 mars 2004, Gjykata Komunale e Pejës e barti rastin tek Dhoma e Posaçme, si gjykatë kompetente sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12) dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13), për gjykim të mëtejshëm (C. Nr. 359/03).
16. Më 12 korrik 2004, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë Dhomës së Posaçme duke kërkuar konfirmimin e pronësisë së këtij lokalit afarist dhe regjistrimin e tij. Po ashtu, AKM-ja u njoftua për fillimin e procedurave.
17. Më 23 tetor 2007, Dhoma e Posaçme: 1) refuzoi ankesën si të pabazë, 2) deklaroi kontratë e shitblerjes si pa bazë ligjore, 3) urdhëroi parashtruesin e kërkesës t'ia dorëzojë lokalin afarist NSH, 4) dhe udhëzoi NSH t'i jep kompensim parashtruesit të kërkesës (SCC-04-0104).
18. Dhoma e Posaçme u arsyetua se bartja e lokalit afarist u bë sipas procedurave të duhura të tenderimit, nga çka fiton parashtruesi i kërkesës dhe se kjo është kryer konform dispozitave të Ligjit mbi kushtet e veçanta për bartjen e pronës së patundshme. Dhoma e Posaçme më tej deklaroi se, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dëshmi që ka paguar së paku, 30.000 marka gjermane (në tekstin e mëtejme: MGJ) nga ato 40.500 MGJ, në gusht të vitit 1993. Pra, lokalit afarist do të duhej të ishte tek parashtruesi i kërkesës. Sidoqoftë, kjo nuk ndodhi, për arsye se Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Pronësore në Ministrinë e Financave të Republikës së Serbisë kishte vendosur që, një shitje tillë ishte në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Kufizimet e Transaksioneve (bartjeve) të Patundshmërisë, i cili nuk është më në fuqi, ngase ishte legjislacion diskriminues, sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24). Rrjedhimisht, lokalit afarist iu shit nga NSH personit të tretë dhe u arrit një lloj marrëveshje kompromisi me parashtruesin e kërkesës që të ndërrohej pronësia e lokalit afarist me ndonjë lokal tjetër afarist. Kjo ishte konfirmuar nga Drejtori i NSH. Sidoqoftë, nuk është dorëzuar ndonjë kopje e vërtetuar apo origjinal i një kontrate të tillë. Dhoma e Posaçme vendosi që bartja nuk është bërë në pajtueshmëri me Ligjin mbi Transferimin e Pronës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pohon se Dhoma e Posaçme ka kryer shkelje të rënda të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, "duke mos ftuar palët në procedura, duke marrë një aktvendim të mangët dhe duke mos njohur shitblerjen e lokalit afarist". Sidoqoftë,

Dhoma e Posaçme konfirmoi shumën e paguar për lokalin afarist në vend të njohjes së pronësisë ndaj lokalit afarist.

20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës ankohet se nuk i ishte dhënë e drejta për ankesë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Dhomës së Posaçme, të 23 tetorit 2007, që edhe ka kryer shkelje serioze të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, duke mos ftuar palët në procedura, duke marrë një aktvendim të mangët dhe duke mos njohur shitblerjen e lokalit afarist.

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës.

23. Si një nga kushtet, parashtruesi i kërkesës duhet të vërtetojë se ka paraqitur kërkesën brenda afatit kohor prej 4 muajsh nga marrja e vendimit për rastin e tij, siç parashihet në nenin 49 të Ligjit. Sidoqoftë, nga parashtruesat e parashtruesit të kërkesës duket se vendimi i fundit për rastin e tij ishte Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme, i 23 tetorit 2007, i cili i ishte dorëzuar më 14 korrik 2008, ndonëse ai paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës tek më 18 nëntor 2010, që është më tepër se 4 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit (shih nenin 56 të Ligjit). Nga kjo del se kërkesa është jashtë afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, ngase do të duhej të paraqitej në Gjykatë më 15 maj 2009.

24. Për më tepër, sipas nenit 50 të Ligjit, thuhet se:

“Nëse parashtruesi, pa fajin e tij, nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj”.

Gjykata vëren se vendimi i fundit parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar më 14 korrik 2008, dhe sipas nenit 50 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës do të duhej të kishte paraqitur kërkesën më 14 korrik 2009, gjegjësisht një vit pas vendimit të fundit që i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës. Pasi që kërkesa ishte paraqitur më 18 nëntor 2010, kërkesa është jashtë afatit të paraparë kohor.

25. Në këto rrethana, kërkesa duhet të refuzohet si e paafatshme në bazë të nenit 49 në lidhje me nenin 56 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe neneve 49 dhe 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe Rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 21 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHE POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtueshmëri me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani